



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-17249/22 datë: 01.07.2022



Npi – 01/208 datë: 04.07.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 04.07.2022, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 04.07.2022 (e hënë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje përveq Kryesuesit z.Bajram Ilazi dhe anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, znj.Shkurte Behluli dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Praktikantja, znj.Valmira Hoxha. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK me 23.06.2022,
2. Diskutim mbi punësimin e komuniteteve në institucionet publike (Të ftohet zyra për punësim)
3. Propozim - rekomandimi për punësimin në ZKKK në 2 pozita,
4. Propozim për zgjedhjen e përfaqësuesve të KPK për takim me Kryetarin e Komunës për të diskutuar kërkesat e komunitet. pakicë dhe raportin e punës për periudhën prill-qershor 2022.
5. Propozim për asamblen komunale për lirimin nga pagesa për legalizim të ndërtimeve pa leje dhe diskutim për projektet infrastrukturore për komunitete (Të ftohet Drejtori për Urbanizëm),
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës së KK-së për periudhën prill-qershor 2022, dhe shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të komuniteteve nga kryesuesi i KK.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK me 23.06.2022.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pike.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 23.06.2022.**

Pika 2

Diskutim mbi punësimin e komuniteteve në institucionet publike (Të ftohet zyra për punësim)

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Idajet Rexhepi, bashkëpuntor i Kuvendit; Përshëndetje, unë vetem desha të ju njoftoj se unë e kam njoftuar me kohë Kordinatorin e zyrës komunale për punësim, znj.Selvisha Bajramin, ndërsa arsyen pse nuk merr pjesë në mbledhje nuk e di dhe nuk kam ndonjë informacion se pse nuk ka ardhur.

z.Besnik Seferi; Ne edhe në Kuvend e kemi ngritur çështjen e mungesës të personave përgjegjës, në mbledhjet e Komiteteve, dhe kemi kërkuar që drejtorat të vijnë në mbledhje.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Unë këtë qështje do ta bisedoj edhe me Ministrin e MAPL-së, por do të bisedoj me Kryetarin dhe do të kërkoj që në mbledhje të vijnë drejtorat dhe zyrtarët e institucioneve lokale. Unë ju falënderoj për visitën që e kemi bërë të familjet e komunitetit pakicë. Realisht unë kam pritë që në mbledhje do të vie përfaqësuesi i zyrës për punësim, dhe ta diskutojmë qështjen e punësimit të komunitetit pakicë.

Pika 3

Propozim - rekomandimi për punësimin në ZKKK në 2 pozita

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, lexoi Propozim-Rekomandimin për punësim nga ZKKK-ja. Unë besoj se zoteri Ibrahim Demiri këtë do ta sqaronte më mirë, mirëpo nuk ka pas mundësi sot të merr pjesë në këtë mbledhje për arsye se ishte duke punuar në një Komision për shqyrtimin e kërkesave për punësim.

z.Besnik Seferi; Nuk kemi qka themi më shumë, sipas ligjit nuk është me pa tjetër që këta dy punëtorë në zyrën për komunitete dhe kthim ti takojnë komunitetit pakicë. Para së gjithash duhet me i plotësuar kushtet e parapara me konkurs për tu pranuar.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, në muajin Maj të vitit të ardhshëm Ibrahim del në pension, dhe pastaj mbetemi pa përgjegjës të zyrës për komunitete dhe kthim.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -IV- për vitin 2022, të mbajtur më: 04.07.2022, unanimisht vendosi që t'i Rekomandoi, Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit që të shikojnë mundësinë e plotësimit të dy vendeve të punës, për zyrtarë në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, të Komunës së Shtimes.**

Pika 4

Propozim për zgjedhjen e përfaqësuesve të KPK për takim me Kryetarin e Komunës për të diskutuar kërkesat e komunitetit pakicë dhe raportin e punës për periudhën prill-qershor 2022

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Ndoshta është mirë që të shkojmë të gjithë anëtarët e komitetit të Kryetari.

znj.Shkurte Mustafa; Përshëndetje, unë e propozoj Bajram Ilazin.

z.Besnik Seferi; Çështja, e gjendjes së familjeve të komunitetit pakicë, kur e kam pa me të vërtetë më kan prekur. Dhe më ka bërë të ndjem mjaft keq, sepse atje kemi pa një familje 7 anëtarëshe e cila që 7 muaj nuk kishte energji elektrike. Me këtë visitë kemi pa se ata kanë nevoja shumë të mëdha. Unë propozoj që ne të gjithë anëtarët e Komitetit të shkojmë të Kryetari, dhe të ja shprehim brengat e atyre familjeve, sidomos për ato katër familjet që ishin në gjendje të vështirë.

z.Arton Demiri; Edhe unë mendoj se është më mirë që me shku të Kryetari të gjithë anëtarët e Komitetit.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje.

* Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi, që të shkojnë në takim te Kryetari i Komunës, të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; A ka propozime për datën se kur do të shkojmë te Kryetari.

znj.Shkurte Mustafa; Unë propozoj datën 12 Korrik.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Unë propozoj datën 13 Korrik.

znj.Rrezartë Ramadani; Unë propozoj datën 15 Korrik.

* Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi, që më datën 15 Korrik, të gjithë anëtarët e Komitetit të shkojnë në takim te Kryetari i Komunës.

Pika 5

Propozim për asamblen komunale për lirim nga pagesa për legalizim të ndërtimeve pa leje dhe diskutim për projektet infrastrukturore për komunitete (Të ftohet Drejtori për Urbanizëm)

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, e njoftoi Komitetin për lirim nga pagesa e tatimit të pjestarëve të komuniteteve.

z.Besnik Seferi; Unë nuk dua që ne të marrim ndonjë hap të gabueshëm. Unë them se nëse një gjë të tillë e parashih ligji unë jam "Pro", mirëpo neve, sigurisht që na nevojiten informata shtesë.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Unë them që ne si Komitet të ja bëjmë një rekomandim Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në bazë të rregullores. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje.

* Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -IV- për vitin 2022, të mbajtur më: 04.07.2022, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, që të shikon mundësinë ligjore për ta paraqitur në Kuvend për miratim një Propozim-Vendim për lirim nga pagesa e taksave të gjithë atyre që duan të bëjnë legalizimin e ndërtimeve pa leje, (me akcent për banorët e komunitetit pakicë), duke u bazuar në nenin 20.11 të "Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje Nr.06-L/024".

Pika 6

Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës së KK-së për periudhën prill-qershor 2022, dhe shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të komuniteteve nga kryesuesi i KK

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, e njoftoi Komitetin, se unë nuk e kam përgatitur një raport për Komitetin.

z.Besnik Seferi; Ne e dime se sa mbledhje i kemi mbajtur dhe qfar pune kemi bërë. Unë propozoj që në takimin e ardhshëm ta kemi një raport, dmth. mbledhja e radhës është në muajin Gusht.

Pika 7

Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e Komitetit e përfundoi në ora 15:21 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi